

K R I T I K E E B I B L I O G R A F I

FRANCESCO CRISPI GLAVIANO: Mbi malin e Truntafilevet — Sul Monte delle Rose — Testo e traduzione dell'Autore, con Introduzione, Commento e note di Matteo Sciambra. Palermo 1963, f. CXI-78.

Në krye të veprës studjonjësi ka venë një hyrje prej CXI faqesh, ndarë në dhjetë kapituj, duke na dhënë në fund të saj një pasqyrë të alfabetit që ka përdorë poeti dhe bibliografinë që ka konsultuar studjonjësi.

Të dhjetë kapitujt e hyrjes na japin njoftime të pasura e të reja, të panjohura fare gjer më sot, rreth poetit dhe veprës së tij. Kështu Shambra jep një kontribut të vlefshëm në vlerësimin e këtij poeti shumë pak të njohur gjer më sot. Me vëllimin e Shambres, ne kemi tani materiale të bollshme, për ta futur Frano Krispi Gllavianon si autor të veçantë në kursin e letërsisë arbëreshe të shek. XIX-XX.

Rreth hyrjes ne kemi disa vërejtje të vogla, që po i shprehim më poshtë, aqë sa na e lejon vëndi i një reviste për një recension.

Në kapitullin e parë — Palac Adriano, origjina dhe traditat e tija shqiptare — studjonësi i veprës flet për origjinën e Palac Adrianos. Ai na thotë se shqiptarët e parë kanë ardhur në këtë vend më 1450; pastaj ata kanë vazhduar ta popullojnë fshatin edhe pas 1467 dhe 1533. Mirëpo këto të dhëna nuk përkojnë me vjetin 1482, që na jep Gavril Darë i Riu, si datë të themelimit të kolonisë arbëreshe të Siqilisë, Palac Adriano, në parathënien e «Këngës së Sprasme të Balës».

Botonjësi, si mbështetje të kohës së ardhjes së shqiptarëve në Siqili pra edhe në Palac Adriano, citon Mons. Xhuzepe Krispin dhe e harron Darën; kurse më tutje, në f. XI, kur don të tregojë se cilët qenë themelonjësit e Palac Adrianos, citon Darën. Ne nuk mund të pranojmë që Gavril Darë i Riu, kur jep atë datë, 1482, nuk ishte i informuar mirë rreth kësaj çështje, sepse ai pati një traditë të bukur e të pasur në familje rreth folklorit dhe historisë së traditave shqiptare të kolonivët të Siqilisë, sidomos rreth fshatit të vet, Palac Adriano. Vepra e Mons. Xhuzepe Krispit u botua më 1853, shumë më parë se Dara të shkruante veprën e vet, «Kënka e Sprasme e Balës». Ne na duket se në këtë kapitull, kur flitet për traditat e fshatit Palac Adriano, Gavril Darë i Riu duhesh të zinte një vënd më të gjerë, për kontributin që ka dhënë ai në luftat garibaldine (ai pati edhe ofiqe të larta në kohën e Garibaldit). Aqë më tepër na duket se duhesh folur për Gavril Darë të Riun, kur mendojmë se poeti ynë, Frano Krispi Gllaviano, u frymëzua nga vepra e tij «Kënka e Sprasme e Balës», pa arritur bukuritë e saja. Në lëvizjen letraro-politike Darejtë kanë qenë pionierë për tri gjenerata, veçanërisht në fushën e folklorit e të traditave edhe para Mons. Xhuzepe Krispit në Siqili. Materialet e Darenjëvet pasuruan botimet e vetë Mons. Xhuzepe Krispit, Dhimitër Kamardës dhe të Zef Skiroit senior më vonë, që i përdorën dhe i bënë të njohura në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX.

Ky kapitull mbyllet me një mbishkrim interesant varri të familjes së Krispëvet.

Edhe në kapitullin e dytë — Francesco Krispi Gllaviano — Familja Krispi — studjonjësi kthehet prapë tek traditat e fshatit. Në këtë kapitull interesant është gjenealogjia e hollësishme e familjes së poetit; do të kishim dashur që elementet e jetës së tij të ishin dhënë më gjërë, nganjëherë këto elemente nuk dalin aq të qarta. Kështu nuk kuptohet se me ç'punë delikate e paska ngarkuar i ungji, Krispi burrë shteti, të nipin, poetin, sa ky të mos mundke ta kryejë dhe, i zëmëruar, i ungji ta niste për në fshat.

Nuk e dijmë se sa e ka të qartë studjonjësi politikën ekspansioniste të Krispit, burrë shteti italian, kur na thotë se ai na paska qënë përpjekur për independencën e Shqipërisë. Është e vërtetë se Krispi burrë shteti, në të ritë që republikan garibaldin dhe, sa që i ri, luftoi me idealet e Garibaldit për lirinë e popujve të shtypur, po më vonë, ai kaloi në krahun e djathtë dhe u bë figura më reaksionare e Italisë me politikën e kolonializmit; aqë është e vërtetë, sa kjo politikë kolonialiste dhe disfatat në Afrikë e rrëzuan atë dhe nga posti i Kryeministrit; figura e tij u riabilitua vetëm me politikën imperialiste të fashizmit.

Ky kapitull mund të ishte më i ngjeshur dhe më i dokumentuar. Aty del mirë ajo që ka rëndësi për jetën e poetit: diziluzioni dhe mungesa e arritjes së idealeve të tij; aspiratat e rinisë së tij bëhen hi e pluhur dhe ai kthehet në fshat i dëshpëruar. Kjo del qartë edhe në fillimin e kapitullit të tretë. Peripecitë e jetës së tij plot vuajtje të kujtojnë poetin tjetër arbëresh nga Kalabria, Zef Seremben. Kjo del mirë nga vjersha «Uri», që studjonjësi e ka cituar me vend. Shambra ka ilustruar mirë në këtë kapitull edhe qëndrimin e poetit ndaj lakmonjësvet, në atë vjershë të shkurtër, po të ngjeshur e me ide humanitare. Të kënaq mallkimi i poetit në fund të kësaj vjershe. Po ky kapitull plotëson kapitullin e mëparshëm dhe të dy bashkë mund të shkriheshin në një.

Shambra, në kapitullin e katërt, kur flet për lëvizjen patriotike letrare të arbëreshëve në përgjithësi, shkruan se në këtë lëvizje paska marrë pjesë vetëm De Rada.

Studjonjësi sikur e harron kontributin e madh që kanë dhënë arbëreshët e Kalabrisë në kauzën e çlirimit dhe të bashkimit të Italisë. Shambra mburret me Krispin burrë shteti, për kontributin e arbëreshëve në çështjen e çlirimit dhe të bashkimit të Italisë, po Krispi i tradhëtoi idealet për të cilat kishin luftuar arbëreshët: ndër ta që Gavril Darë i Riu nga Siqelia dhe shumë arbëreshë të Kalabrisë. Ndërsa Krispi u bë Kryeministër i shtëpisë Savoja, shumë arbëreshë kalabrezë, si Vinçenc Stratigoi, Xhenarin Plaku etj., u tërhoqën nga jeta politike të diziluzionuar, sepse monarkia nuk i plotësoi idealet për të cilat ata kishin luftuar: Siqelia dhe Kalabria mbetën në gjendjen feudale të mëparshme edhe si u bë çlirimi dhe bashkimi i Italisë. Dhe Vinçenc Stratigoi, duke pasqyruar këtë gjendje të Kalabrisë, pas 1870, do të thotë me zëmërim: «Si stava meglio, quando si stava peggio!» (ishim më mirë, kur ishim më keq.)

Shambra si arbëresh, kur flet për kontributin e arbëreshëve në lëvizjen garibaldine, nuk duhesh të harronte, se pjesëmarrja e arbëreshëve të Kalabrisë ka qënë kaqë e madhe dhe masive, sa më 1860

vetëm nga fshati Lungo i Kalabrisë, fshat me 5000 banorë, dollën 500 vullnetarë luftëtarë¹).

Vetë Shambra pranon se nxënësit e kolegjit të Palermos i pengoi rektori që të merrnin pjesë në luftën çlirimtare, kurse drejtori i kolegjit të Shën Adrianit në Shënmitër të Kalabrisë, iku nga kolegji bashkë me nxënësit, rrëmbeu armët bashkë me ta dhe u bashkua me Garibaldin.

Në këtë kapitull duket sikur gjithë punën në lëvizjet patriotike të arbëreshëve na e paska bërë Krispi burrë shteti. Po Domenik Damis, nga Lungro e Kalabrisë, që u burgos me 1848, si dështoi beteja e Kampotenezës, i cili ktheu anijen që po i shpinte të mërguar në Amerikën latine dhe e drejtoi për Angli, ku u takua me emigrantët patriotë italianë e që andej arriti në Gjenovë, u bashkua me të njëmijë këmishat e kuqe dhe zbarkoi në Marsalë si garibaldin? Po Xhenarin Plaku, nga Çivita e Kalabrisë, që djalë 20 vjeç u plagos në Kampotenezë, u zu rob, u dënua me burgim të përjetshëm, pati shok burgu patriotin e shquar Luigj Setembrinin dhe, si shpëtoi nga burgu, luftoi me Garibaldin dhe arriti gradën e majorit si Domenik Damis? Për të na flet me admirim Luigj Setembrini në kujtimet e jetës së tij²).

Pjesëmarrjen e kufizuar të arbëreshëve të Siqilisë në lëvizjet çlirimtare garibaldine vetë Shambra e justifikon, kur na thotë në faqen XXXVI, se ata na paskan gëzuar privilegje dhe mbrojtje nga Burbonët e Napolit. Ky është një dokument i vlefshëm që na bën të gjejmë edhe arësyen pse lëvizjet demokratike kanë qenë më masive dhe më të fuqishme ndër arbëreshët e Kalabrisë se sa ndër ata të Siqilisë.

Në këtë kapitull të katërt është për t'u ndrequr një pasaktësi: Dhimitër S. Shuteriqi nuk është autor i vetëm i gjithë vëllimit të dytë të «Historisë së letërsisë shqipe», botuar nga Universiteti Shtetëror i Tiranës, ashtu si e citon Shambra në fq. XXXV. Ky tekst është përgatitur nga një kolektiv i gjerë; emrat e autorëve dhe redaktorëve janë në parathënie dhe në krye të çdo vëllimi.

Lidhur me këtë kapitull vlejné të bëhen edhe dy sqarime përsa i përket Zef Skiroit senior:

1. Zef Skiroi me të vërtetë, në veprat e para, sidomos në «Kënkat e luftës», 1897, predikoi bashkimin e gjithë shqiptarëve kundra turkut dhe këtë bile e bëri me aq zjarr, sa në këtë pikë ra edhe në polemikë me të madhin De Radë, po më vonë, me veprën politike «Shqiptarët dhe çështja ballkanike» (1904), me «Këngët e liktorit» (1926), me botimin e dytë të veprës së madhe «Te dheu i huaj» (1940), poeti i Horës së arbëreshëve predikoi Shqipërinë e 7 prillit 1939; ai luftoi vërtetë me zjarr kundra politikës turke dhe influencës austriake në Shqipëri, po u mundua ta shpëtonte Shqipërinë nga këta dy vënde, që ta gllabëronte pastaj Italia. Ai mbaroi si poet këngëtar i fashizmit, se më 1926, një vit para se të vdiste, shkroi shumë hymne shqip e italisht për fashizmin dhe për Musolinin, të cilin e quajti në vjershat e veta «invitto ed invincibile».

1) Parliamo di Lungro; (Comitato «Commemmorazione del Risorgimento», Corigliano Calabro, 1963.

2) Luigi Setembrini, Ricordanze della mia Vita, Leterza, Bari, pp. 667-674 Vol. II

2. Zef Skiroi senior dështoi edhe në tentativat e tij për një gjuhë shqipe të përbashkët. Në atë përpjekje të tij, ndoshta të singertë, po të pafat, ai bëri një amalgamë të çuditshme gjuhe dhe nuk krijoi një «koine shqiptare».

Gjuha e Zef Skirit senior në veprat pas 1907, është gjuhë e kurrkuj. Kurse ai mbetet pa asnjë dyshim poeti me gjuhën më të pasur dhe më të pastër arbëreshe në veprat «Mili e Hajdhia», «Te dheu i huaj», në botimet e para, 1890, 1900.

Në faqet e para të kapitullit të V, duke dashur të analizojë aktivitetin letrar të autorit, botonjësi na flet më shumë për Zef Pitrenë se sa për Krispin. Kurse në këtë kapitull shumë mirë është bërë ndarja në shkrime të botuara e të pabotuara të autorit, po në nëndarjet, kur klasifikohen poezitë sipas argumenteve që trajtojnë, për disa vjersha jepen vetëm titujt, kurse për disa të tjera edhe përmbajtja me konsiderata të ndryshme, duke përsëritur gjëra që janë thënë edhe në kapitujt e mëparshme. Në këtë kapitull ka gjëra që përsëriten edhe rreth fakteve historike, si Lidhja e Prizrenit e Kongresi i Berlinit.

Shumë gjëra që janë thënë në kapitujt e parë përsëriten edhe në kapitullin e VI. Në këtë kapitull ka edhe ndonjë pasaktësi: «Kënka e Sprasme e Balës» në vëllim të veçantë u botua më 1906 dhe jo më 1902, si e shënon autori në f. LII. Ajo u botua pjesë-pjesë në «Nacione Albanese» të Anselmo Lorekjos, duke nisur nga Nr. 13 i 1900-tës.

Përsëritje të gjëravet që janë thënë ka edhe në kapitullin e VII. Këtu autori sikur harron titullin e kapitullit «Temperamenti artistik i Krispit dhe vlera e poemthit» dhe na flet për temat e ndryshme që ka trajtuar poeti në shkrimet e veta. Kapitulli nuk është i qartë në ndarje dhe është shumë i ngarkuar. Në të, ashtu siç prisnim, nuk na jepet një vlerësim i poemës nga ana artistike, dhe kjo gjë nuk bëhet në asnjë vend të studimit.

Edhe në kapitullin e VIII studjonjësi, në vend që të analizonte anën gjuhësore të poemthit, bën më shumë histori. Nga pikëpamja gjuhësore studjonjësi i jep Krispit një vend që nuk e meriton. Kur krahasojmë gjuhën e tij me atë gjuhë aqë poetike të Gavril Darë të Riut, Frano Krispi Gllaviano nuk e ka fuqinë poetike të bashkëfshatarit të tij të «Këngës së Sprasme të Balës».

Frano Krispi Gllaviano ka një gjuhë të tijën, me fjalë që nuk i gjen as në gjuhën popullore, as në autorë të tjerë arbëreshë; këtë e pranon edhe studjonjësi kur shumë herë në shënimet gjuhësore flet për «krijime personale». Krispi u nis sigurisht nga qëllime të mira, po ka krijuar shumë neologjizma të pafat dhe jashtë rregullave dhe sistemit gramatikor të shqipes; duket se nuk kishte kulturë linguistike. Duke patur parasysh këtë të metë esenciale në punë të gjuhës, ne na duket se Shambra e tepron në këtë kapitull, kur na thotë se gjuha e Krispit është gjuha e të folurit sikulo-shqiptare.

Në kapitullin e IX përsëriten gjëra që janë thënë edhe në kapitullin V dhe VI. Kështu, si flitet për shëmëll në f. LIII për këngën e njohur «O e bukura More», që këtu na është dhënë integrale, në 9 vargje, vargje po të kësaj vjershe përsëriten edhe në faqet LXXXVII-LXXXIX të këtij kapitulli.

Në kapitullin e fundit studjonjësi shprehet si me ndrojtje, sepse ka përdorur në grafi alfabetin «zyrtar shqiptar», si thotë ai vetë. Këtu s'ka asgjë të keqe. Veçse duke përdorur alfabetin «zyrtar shqip-

tar» të mos ishin cënuar veçoritë fonetike të së folmes arbëreshe të Palac Adrianos. Mënyra e zbatimit të këtij kriteri nuk na duket e drejtë, se nuk na është dhënë ekzakt teksti i Krispit nga pikëpamja fonetike, gjë që e pranon edhe vetë studjonjësi, kur na flet për këtë çështje në fund të faqes C dhe në fillim të faqes CI. Përse e ka eliminuar *lj*-në, kur vetë pranon se ekziston dhe se është e rëndomtë në të folmen shqiptare të Palac Adrianos? E thotë vetë studjonjësi: e paska eliminuar këtë partikolaritet fonetik, sepse u përkaka të folurave të izoluara dhe sepse nuk ekzistua në alfabetin e sotëm të gjuhës shqipe. Po Krispi vetë ama e shprehu me një llanda greke.

Tendenca që kanë nisur studjonjësit arbëreshë, duke na dhënë tekste të letërsisë arbëreshe, të transkriptuara në alfabetin «zyrtar shqiptar», pa na dhënë në mënyrë ekzakte fonetikën e atyre teksteve, nuk është e justifikuar. Ky kriter mund të përdoret vetëm kur duam të bëjmë të njohura tekstet arbëreshe në masat e gjëra, po ato nuk mund t'i vlejné studjonjësit linguist, që kërkon të njohë ndryshimet fonetike të dialekteve dhe të nëndialekteve.

Një kriter i tillë në transkriptimin e teksteve arbëreshe mund të na falesh ne studjonjësvet shqiptarë, që nuk kemi mundësinë të njohim nga afër ndryshimet fonetike, po jo një studjonjësi arbëresh që jeton dhe është çdo ditë në kontakt me të folurat e ndryshme të fshatarëve arbëreshë. Si ndryshimi i *l*-së me *lj*-në në gjuhën arbëreshe ekziston edhe ndryshimi i *q*-së me *kj*-në.

Si bëme këto vrejte të veçanta kapitull për kapitull në studimin e Shambres, vrejttet tona të përgjithëshme, duke përmbledhur edhe ato që thamë, janë këto:

Të gëzuar që doli në dritë kjo vepër, ne e themi me sinjeritetin më të madh, se Papis Mateo Shambra i ka bërë një shërbim shumë të vlefshëm letërsisë arbëreshe në veçanti dhe letërsisë shqipe në përgjithësi, duke botuar këtë poemë dhe shumë vjersha të panjohura të Frano Krispi Gllavianos. Me studimin e hyrjes dhe me vrejttet e shumta gjuhësore brenda tekstit, Shambra ka bërë një punë të madhe plot durim studjonjësi të vërtetë e serioz, si nuk është bërë gjer më sot për një letërsi arbëreshe nga ndonjë arbëresh. Poeti Frano Krispi Gllaviano ishte shumë pak i njohur para botimit të librit të Shambres; ai njihej vetëm me disa poezi të shkurtra dhe nganjëherë edhe të parëndësishme nga përmbajtja të botuara nëpër organe të ndryshme, kohë të ndryshme shumë të largëta, si «Fjamuri i Arbërit», «Kombi» i Bostonit, dhe në vitet e fundit ndonjë vjershë e tij u botua në faqet e Buletinit të Universitetit Shtetëror të Tiranës. Na dimë se Krispi Gllaviano veç poemës së gjatë, na ka lënë në dorëshkrim edhe më se 40 vjersha, nga të cilat për fat të mirë disa na i jep Shambra, edhe nga ato të panjohurat, si «Lakëmuesi», «Ndiezor», «Lajtaria të Kroit të madh», «E falura të Dalanishëzes» etj. Po Shambra do të kishte bërë mirë sikur të na kishte dhënë bashkë me poemën e me ato vjersha të pakta, të gjitha vjershat e poetit. Po si del nga studimi i tij, Shambra disponon materiale të tjera të shumta të panjohura të poetit dhe ne i urojmë që së shpejti, të na japë një botim të plotë të shkrimeve të Frano Krispi Gllavianos.

Me botimin e poemës «Mali i Trutafilet» dhe disa vjershave të tjera të panjohura gjer më sot, letërsisë së Rilindjes arbëreshe i shtohet një autor, që me kohë duhet të zërë vendin e vet të merituar

në kursin e përgjithshëm të kësaj letërsie. Poemës dhe vjershaves të Krispit u duhet bërë një analizë e mirë, e hollësishme dhe e plotë nga përmbajtja dhe nga forma, që mungon në studimin e Shambres. Duke u shtrëdhur dhjetë kapitujt, studimi mund të dilte më i ngjeshur e më organik, në një hyrje e në tre kapituj.

Si hyrje të zinte vendin kapitulli i katërt: Lëvizja letraro-politike e arbëreshëve të Italisë. Në kapitullin e dytë të hynin kapitujt II, III, V, me këtë titull: Jeta dhe vepra e Frano Krispi Gllavianos,

Në kapitullin e tretë, ku të përmbledheshin kapitujt VI, VII, VIII, IX e X, të jepesh një analizë më e plotë e poemës, duke përmbledhur përmbajtjen e vlerësimit nga ana artistike, gjuhësore, me influencat nga folklori dhe nga autorë të tjerë, sepse poetit Frano Krispi Gllaviano nuk mund t'i mohosh ndikimet nga Dara i Ri dhe nga Serembe, tjetër punë se ai nuk mundi të arrinte asnjërin në art.

Kështu studimi do të paraqitesh edhe më i kapshëm e pra edhe më i kuptueshëm për studjonjës.

Pas hyrjes së gjatë studjonjësi na jep tekstin origjinal të poemës me përkthimin italisht pranë, bërë nga vetë autori, Frano Krispi Gllaviano. Poema gjithësejt ka 1085 vargje, ndarë në 49 këngë; kënga më e shkurtër (XXXVIII) ka vetëm 8 vargje dhe më e gjata (XLVIII) ka 108 vargje. Tekstin e shoqërojnë në fund të faqes komente të pasura gjuhësore.

Vrejtjet tona të përgjithëshme rreth komentit të tekstit janë këto:

Që në fillim të kreit të poemës studjonjësi duhesh të na kishte sqaruar menjëherë për të na thënë se ç'është ky «Mali i Truntafilevet» në rrethet e fshatit Palac Adriano, ç'ceremoni zhvilloheshin atje, sa u është përmbajtur poeti ceremonive, ç'ka sjellur të re etj., se ndryshe lexonjësi e ka të vështirë të kuptojë poemën. Me një sqarim të tillë në krye lexonjësi përgatitet mirë të kuptojë poemën që në fillim të leximit.

Është e vërtetë se në krye të çdo kënge studjonjësi na jep shumë herë të zgjatur pa nevojë përmbajtjen e saj. Studjonjësi në fund të çdo kënge, me komente të ndryshme ka shpjeguar fjalët, po si pjesa e hyrjes edhe kjo punë me vretje gjuhësore është shumë e rënduar. Në studimin e Shambres lexon gjithë atë hyrje, gjithë ato komente brenda për brenda tekstit, po nuk na është dhënë një përmbajtje e përmbledhët, sado e shkurtër, e saktë e poemës, me rrjedhimin e ngjarjevet që përshkruhen aty. Të gjitha komentet janë gjuhësore, ndonjë koment estetik jepet nepër përmbledhjen e çdo kënge; komentet estetike ishin të nevojshme për të vlerësuar veprën nga ana letrare. Studimi del kështu shumë i shpërndarë.

Në hyrjen e çdo kënge ka komente të zgjatura me fjalë, që nuk e shpjegojnë këngën; kjo të bje në sy për çdo këngë. Le të merren për shëmbëll 25 vargjet e këngës së dytë me 13 rradhët me shkrim të imët të hyrjes së kësaj kënge.

Edhe shpjegimi i fjalëvet nga komentatori është shumë i rënduar, aty ka vretje të drejta krahasonjëse shumë të vlefshme, po ç'nevojë ishte të jepesh përkthimi i çdo fjale edhe italisht, kur atë përkthim e ka teksti i përkthyer që e ka bërë vetë autori?

Edhe komentit dhe shpjegimi i fjalëvevet ka nevojë për një kritikë, po ne këtë pikë nuk po e prekim; ia lemë ndonjë kompetenti.

Tani po përpiqemi të vlerësojmë poemthin e Frano Krispi Gllavianos, po për ta bërë këtë na duket e domosdoshme të japim një përmbledhje të përmbajtjes së tij:

Poemthi veprim qëndror, nëqoftëse mund të flitet për një veprim, ka të vajturit e tërë banorëve të fshatit Palac Adriano mbi «Malin e Trutafilet», nga ku pleq e të rinj, të drejtuar nga lindja, vështrojnë dhe kujtojnë me mallëngjim atdheun e tyre të lashtë, po të largët, Shqipërinë.

Veprimi nis një mëngjes korriku që pa gdhirë, kur me radhë, tërë banorët e këtij fshati arrijnë në Malin e Trutafilet; atje ia marrin këngës me brengë, duke kujtuar fitimtar flamurin e Skënderbeut.

Dielli ka lindur mirë, kur në mes të turmës poeti sheh të dashurën e vst. Tërë fshatarët mbushin ngrushtet me dhe dhe e hedhin atë drejt bregut shqiptar, me dëshirë që ta marrë era dhe të vejë e të mbulojë lulet e varrevet të të parëvet të tyre në Shqipëri. Në mes të kësaj ceremonije mallëngjenjese, një vajzë këputet nga grupi dhe ia merr këngës së njohur «O e bukura More!»

Poeti i drejtohet Malit të Trutafilet, duke iu lutur që të shndërron e të bëhet kalë, t'i marrë të gjithë, t'i shpjerë në Shqipëri dhe atje, djem e vajza, të armatosur të venë dhe t'i vrasin turqit.

Të gjithë, duke rrahur gjoksin, duke shikuar drejt lindjes, përsërisin këngën «O e bukura More!»

Në këngët që vijojnë përmënd emrat e shtepive të para shqiptare që duhet të kthehen në Shqipëri, për të shpëtuar nga turku me luftë.

Në këngën e XV poeti lidh idenë e dashurisë së atdheut me idenë fetare, ashtu si ndodh shpesh herë në poezinë pipullore arbëreshe; kështu ai na tregon se si arbëreshët, kur ikën nga Shqipëria, kanë sjellë aty mbi Malin e Trutafilet fytyrat e Zonjës së Këshillit të Mirë dhe atë të Shën Kollit. Me këto veprime vazhdon tërë dita dhe, kur dielli është në perëndim, vajzat i drejtohen diellit dhe të gjithë përqafohen, duke i kënduar një këngë mallëngjenjese Shën Mërisë.

Tani nata ka mbuluar malin, kur dalin laskuriqët e natës, nga të cilët trëmben vashat; djem e vajza mbledhin shkarpa për të ndezur zjarrin e natës. Rreth zjarrit djem e vajza ia marrin prapë këngës, duke kënduar: O e bukura More! motiv, që përsëritet si një refren në shumë këngë të poemthit.

Laskuriqët, armiq të dritës, bien e digjen në zjarr, ata përfaqësojnë shpirtërat e ligj të turqëvevet.

Me këngët që vijojnë arbëreshët duan të ngjallin shpirtërat e fare fisit. Kënga e tyre kujton Shqevën, të fejuarën e Tanushit, e cila, si i vdiqën i ati, e ëma, i fejuari, e si luftoi rreth Krujës, ka ardhur në Palac Adriano, e aty i ka plasur zemra nga hidhërimi, me këngën «O e bukura More» në gojë.

Poeti i drejtohet hijes së Shqevës, që t'i rrëfejë fundin e Sulltanit dhe të Ballabanit në rrethet e Krujës, po ajo nuk i përgjigjet, se nuk dallohet më as guri mbi varrin e saj; me kohë edhe eshtrat e saj

janë bërë pluhur. Pas mungesës së kësaj përgjigje, arbëreshët këndojnë e qajnë njëkohësisht.

Poeti i ankohet Perëndisë për fatin e Shqipërisë dhe të shqiptarëve të shpërndarë nëpër botë të huaj, i kërkon ndihmë që të ndërhyjë për shpëtimin e Shqipërisë. Si nuk mer as këtu ndonjë përgjigje, me gojën e fshatarëve poeti jep kushtrimin për të rrokur armët, që të venë të gjithë të çlirojnë atdheun, Sulin, Krujën, Sfetigradin.

Në këngën 28 poeti ankohet se shumë arbëreshë vendas kanë humbur gjuhë e zakone shqiptare. Ai i drejtohet kraterit të Etnës, duke iu lutur që të tundë eshtrat e të parëvet arbëreshë të vdekur në dhe të huaj, të ngrihen e t'u kujtojnë brezave të rinj zakone dhe gjuhë shqiptare e në atë gjuhë t'ia marrin të gjithë së bashku këngës: «O e bukura More! Prapë me gojën e një prifti flokëbardhë, poeti i drejtohet Etnës, duke iu lutur që të vjellë zjarr e ta leshojë atë mbi armiqtë turq në Shqipëri. Pas kësaj lutje, prifti, me lot ndër sy, këndon këngën: «O e bukura More!

Sapo nis të zbardhë drita, arbëreshët shohin bregun shqiptar atje përtej dhe ia marrin këngës; «O e bukura More! Në këngën XXXI pleqtë tregohen të lodhur dhe duan të kthehen në fshat nëpër atë udhë nga e kishin sjellë dikur në Malin e Trutafilëve mbretin e Burbonëve. Fundi i kësaj kënge është si të thuash një elozh i atij mbreti, që na paska qënë treguar i mirë me arbëreshët, si mirënjohje të shërbimeve të tyre.

Pleqtë duan të ikin, pse janë të lodhur, po të rinjtë e të rejat duan të qëndrojnë edhe aty, që të shohin se si do të lindë dielli dhe të shohin në se është e vërtetë, se ai, dielli, do të kacafytet me hënën.

Në këngën XXXIII tregohet urrejtja për hënën, që është simbol i turqëve, e që natën mbron hajdutët, dhëpërat dhe ujqët.

Në këngët XXXIV-XXXVI vazhdon të përshkruhet urrejtja kundra hënës, lutjet drejtuar diellit që të lindë sa më parë e të vejë e ta vrasë hënën, dielli që ka qënë gjithnjë mbrojtës i Kastriotëve të vijë dhe t'i marrë arbëreshët në qerren e vet edhe t'i shpjerë në Morenë e bukur.

Në këngën XXXVIII, si mbarojnë lëvdatat për diellin, të rinj e të reja mblidhen në një shesh, ku është zakon të grumbullohet bora vit për vit, që e përdorin pastaj në verë.

Në dhjetë këngët nga XXXVIII-XLVIII flitet se si në atë shesh është ngritur një shatore e zbukuruar me sexhadera, me lule kaqë të bukura, sa poeti nuk din t'i përshkruajë. Në ato sexhadera nëntë motra kanë endur fytyra dhe ngjarje nga historia shqiptare, duke nisur nga Aleksandri i Madh me Pirron, gjer tek i biri i Skënderbeut.

Si përshkruhet kështu shatorja, poeti përshkruan një sofër të pasur, me gjellë të mira, pemë e verë të shijshme. Aty do të zhvillohet dasma e më të diturit të fshatit, doktorit të fshatit, me të bijën e priftëreshës. Veprimi zhvillohet me këshilla dhe levdata drejtuar nuses nga një poet; gratë nga ana e tyre i këndojnë dhëndërrit.

Në këto këngë të fundit, duke nisur nga motive të këngëve popullore të dasmës, poeti ka qëllim të na tregojë disa nga ceremonitë e kësaj ngjarje të rëndësishme në jetën e njeriut. Kënga XLVIII mbyllet

me ardhjen e një pëllumbi në mes të sofrës; ai ka varë në qafë një le-
tër. Me këngën XLIX mbyllet poemthi, ku poeti na jep përmbytjen
e letrës së pëllumbit, që vjen nga Shqipëria me këtë thirrje të bukur
e fisnike:

Më mos bëni vajtime;
Mos darkoni m'atë mal;
Gjithë nderat e martesjes
Po të sbiren lini njize!¹⁾
Hera arrejti të vini
Këtu te dheu ku jini pritur;
Këtu ku rrini edhe rropi²⁾
Gjith vllëzërit hidhisur!³⁾
Mirrni dufnë⁴⁾ me grushtin;
Rrethoni kordh e cabje njize;
Po rrëjidhni⁵⁾, fluturoni,
Ejani, ejani te lufta;
Mos sbirni një sahat!
Këtu ju duam edhe bashk
Të luftoni gjith me ne!
S'është më her⁶⁾ të vajtoni
Mbret! Me zjarmin ikur gjirit
Po këntoni lefterimen⁷⁾
Të të Shqipitë dhe sbierrjes:⁸⁾
Turqit vafshinë ndë Pis⁹⁾.

Vargje që duan të thonë: Leni dasmën, rrëmbeni armët, ngjeshni shpa-
tat dhe ecni të luftoni bashkë me ne për Shqipërinë dhe t'i shpijem
turqit në ferr.

Sikurse mund të shihet nga kjo përmbledhje e thatë dhe e shpejt-
të poemthi ka shumë digresione, pa pasur asnjë unitet vepra, pa një
veprim qendror, pa një personazh. Auktori nga qëllimi i vet për
të treguar mallin e fshatarëve arbëreshë të Palac Adrianos për Shqi-
përin'e e largët nga «Mali i Trutafilet», hyn edhe na përshkruan
gjatë, pa lidhje fare me atë qëllim, shatoren, ku do të zhvillohet
dasma, ai kalon pastaj dhe na përshkruan vetë dasmën, pa asnjë lidhje
me qëllimin kryesor të poemës.

Mbyllja e poemës është e bukur dhe poetike: mesazhi i pëllum-
bit i fton fshatarët të lenë dasmën dhe të venë të luftojnë për çli-
rimin e Shqipërisë. Kështu dasma është lidhur mirë me fundin e
poemës.

1) njize = shpejt.

2) rropi = robër

3) hidhisur = përbuzur

4) dufnë = pushkën

5) rrëjidhni = rëndëni

6) S'është më her = S'është më koha

7) lefterimen = Lirinë, çlirimin.

8) Të të Shqipitë dhe të sbierrjes = Të Shqipërisë së humbur.

9) Pis = ferr.

Poemthi (Mbi Malin s Trutafilevet) është një përpjekje e poetit që brënda tij të na japë jetën me zakonet e ndryshme të Palac Adrians. Po Krispi nuk e ka fuqinë poetike të Darës për të na dhënë një poemë të plotë dhe organike, se, si e thamë, poema s'ka as personazh të spikatur, as unitet veprimi.

Franco Krispi Gllaviano, duke marrë për model poemat e Gavril Darë të Riut dhe sidomos të Zef Skiroit senior, «Këngën e Sprasme të Balës» dhe «Mili e Hajdhia», u përpoq të shkrijë në poemë shumë motive të folklorit, po kjo përpjekje tek ai nuk pati as suksesin as fatin e dy poetëve të tjerë të mëdhenj arbëreshë të Siqilisë; bile tek Krispi me atë përsëritje të disa motiveve të folklorit poema bëhet monotone, e mërzitëshme, sepse ato motive shumë herë janë futur artificialisht, kurse tek Dara dhe tek Skiroi vijnë krejt në mënyrë të natyrshme e të lidhur mirë me tërësinë e poemave. Kështu për shëmbëll sa natyrshëm është futur në këngën e XI të «Mili e Hajdhia» episodi i Donikës që u tregon vashavet të fshatit plaku Dodë. Krispi do të kishte mundur të na jepte një figurë të bukur dhe fisnike në fytyrën e Shqevës, po nuk e arriti dot, se, si nis ta përshkruajë, e lë në rrugë pa e mbaruar. Krispit i mungon fuqia e fjalës artistike, sensi i unitetit, koncizioni i habitshëm i fjalës artistike të Darës. Poezia e Krispit s'ka fuqinë rrëmbyese të epikës së Darës e të Skiroit, as ëmbëlsinë e lirikës së tyre.

Poemthi «Mbi Malin e Trutafilavet» ka edhe dobësi të theksuara gjuhësore. Poeti ka maninë të krijojë neologjizma të shumta nga fjalët bazë të shqipes, po janë neologjizma që, po nuk pate tekstin italisht pranë, nuk i kupton fare. Ja disa nga këto neologjizma: Laitaria, larësja, rrobellarësja; i jashtëdaluri, i mërguari; perëndori i Zaires, perëndimi i Zaires; prëndëdimri, vjeshta, ndoshta krijuar për analogji me fjalën pranvera. Gjuhën e dobëson edhe një mani tjetër e tij me të cilën ai i jep shumë herë fjalët jo në trajtën e tyre të zakonshme, po të deformuara. Kështu fjalën «pushim» e jep të deformuar «pushi», ku nuk din as se ku të veshë theksin; fjalën Shqipëri, si duket në vargun e parafundit të vjershës që dhamë në f. 179 e jep me trajtën Shqipitë.

Ai krijoi edhe disa neologjizma të formuara drejt sipas natyrës dhe strukturës gramatikore të shqipes, po as ato nuk patën fat, ndoshta sepse vepra e tij nuk u njoh sa duhet e kështu në njiheshin edhe fjalët. Ja ndonjë nga këto neologjizma: Djegëzore, ndiezor (sonet, tingëllim) përsëlore, bredhëlor, gjetor (gjahtar), etj.

Vepra e Franco Krispit Gllavianos «Mbi Malin e Trutafilevet» për përmbajtjen e saj patriotike, për atë noti të trishtuar të nostalgjisë së atdheut të lashtë, po të largët, për admirimin e lufttrave të popullit shqiptar në të kaluarën për liri e pavarësi, duhet të zërë vendin e saj të merituar pranë poemave «Kënga e Sprasme e Balës», pranë poemave të Skiroit «Mili e Hajdhia» dhe «Te Dheu i Huaj», ndonse poezia e tij nuk arrin kulmet e poezisë së Darës dhe të Skiroit.

Franco Krispi Gllaviano duhet të zërë vendin e vet në kursin e letërsisë arbëreshe, si një poet që ka dëshëruar sinqerisht dhe ka luftuar për çeshtjen e çlirimit të atdheut të tij të lashtë. Ai duhet të bëhet i njohur me poemën «Mbi Malin e Trutafilevet», me vjershat patriotike «Paravera të jashtdalurit», «Jashta Arbërisë», «Qeni Musko-

mend», «Flamuri», «E dashura e luftarit», «E thirrura e Arbërit», «Mbi varrin e Zotit G. Dara», «E falura të Dalanichezës» etj.

Frano Krispi Gllaviano duhet bërë i njohur me vjershat me përmbajtje shoqërore si «Uri» dhe «Lakmuësi». Në këto vjersha me përmbajtje shoqërore, sidomos në «Lakmuësi», ai ngrihet kundër klasave shfrytëzuesë. Në këtë pikë shokun ia gjejmë në letërsinë arbëreshe vetëm në vjershat shoqërore e politike të Vinçenc Stratigoit, po jo me atë forcë proteste si tek poeti i Lungros.

Frano Krispi Gllaviano na ka lënë edhe shumë vjersha erotike, ku na duket një poet naiv, po me sentiment; në këto vjersha ai i këndoi dashurisë së tij të pafat, e cila i përgjjet shumë asaj të Zef Serembes; me këtë poet poezia e tij erotike ka shumë nota të përbashkëta, bile nuk përjashtohet ndikimi direkt nga Serembe, se poeti i Palac Adrianos kishte një simpati të veçantë për poetin e Strigarit, ndoshta sepse në jetë që të dy qenë fatkeqë dhe vuajtën shumë.

Frano Krispi Gllaviano mbetet një poet popullor, ndonëse motivet e folklorit dhe figurat poetike të bukura të poezisë popullore ai nuk dijtë t'i shkrijë nepër veprat e veta me mjeshtërin'e Darës dhe të Zef Skiroit senior. Ekstravagancat e tij në gjuhë ia humbasin nganjëherë veprës karakterin popullor, ashtu si është përpjekur poeti të paraqesë atë vepër me gjithë ato motive të folklorit.

Botonjësit dhe përhapësit të veprës së poetit Frano Krispi Gllaviano, të nderuarit Papas Mateo Shambres, i urojmë që në një të ardhshme sa më të shpejtë të na japë një Krispi të plotë, me të gjitha poezitë e tij të panjohura gjer më sot.

Ziaudin Kodra

